

**VENDIM**  
**Nr. 820, datë 26.12.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 519, DATË 20.9.2017, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR  
TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 29/2024, “Për burimet ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 519, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në titull dhe në tekstin e vendimit, emërtesa “Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT)” zëvendësohet me “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU)”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, si autoritet kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe si organ qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- |                                                                     |                        |
|---------------------------------------------------------------------|------------------------|
| - ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë                         | anëtar;                |
| - ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit                   | anëtar;                |
| - ministrin e Drejtësisë                                            | anëtar;                |
| - ministrin e Turizmit dhe Mjedisit                                 | anëtar;                |
| - ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural                        | anëtar;                |
| - ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit        | anëtar;                |
| - ministrin e Mbrojtjes                                             | anëtar;                |
| - ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale                    | anëtar;                |
| - ministrin e Financave                                             | anëtar;                |
| - drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit | anëtar dhe sekretar.”. |

3. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Sekretariati teknik i KKTU-së zbardh vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar. Vendimet nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretarit të KKTU-së. Vendimet nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe hyjnë në fuqi menjëherë.

Në rastin e zbardhjes së vendimeve, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, sekretariati teknik koordinon veprimet me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet për dhënie lejeje apo autorizimi, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe, kur është rasti, dhe nga sekretari i KKTU-së, dhe hyjnë në fuqi menjëherë.”.

4. Vendimi nr. 198, datë 3.4.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

II. Ngarkohen të gjitha institucionet e përcaktuara në pikën 2, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**